

## UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

**September 26** - East-West BAYERN Forum

### DIRECTOR'S NOTE

#### Të nderuar anëtarë,

Javën që po lëjmë pas angazhimi i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe ekipit të saj ka qenë në disa drejtime. Po ndajmë me ju një përmbledhje të ngjarjeve të rëndësishme që lidhen me zhvillimet ekonomike që afektojnë në punët e bizneseve:

#### Dear members,

During the past week, the German-Kosovar Business Association and its team have been engaged in various directions. We would like to share with you a summary of important events related to economic developments that impact businesses:

#### Raporti ekonomik: Gjermani-Kosovë

OEGJK ka përgatitur raportin ekonomik i cili pasqyron marrëdhëniet tregtare dhe ekonomike në mes të Kosovës dhe Gjermanisë.

Eksportet e mallrave në Kosovë mbeten stabile në vitin 2022, ndërsa importet nga Kosova pothuajse dyfishohen gati dhe tejkalojnë nivelin para krizës. Kompanitë gjermane furnizuan kryesisht mjete transporti dhe pjesë këtyre mjeteve, kimikate dhe materiale plastike. Eksportet e mallrave me Gjermaninë mbeten stabile në një nivel të ngjashëm të 88 milionë euro në vitin 2022. Importet nga Gjermania rriten me 42% në 610 milionë euro.

Kompanitë gjermane ofruan shërbime transporti në Kosovë dhe Kosova ofroi shërbime TIK në Gjermani, ndërsa eksportet e shërbimeve rriteshin në vitin 2021 me 43.5 milionë euro dhe importet nga Kosova shkonin në 268 milionë euro.

Raportin mund ta shkarkoni përmes këtij linku: <https://oegjk.org/wp-content/uploads/Raporti-ekonomik-De-Ks.pdf>

#### Economic Report: Germany-Kosovo

KDWW has prepared an economic report that reflects the trade and economic relations between Kosovo and Germany.

Exports of goods from Kosovo remained stable in 2022, while imports from Kosovo almost doubled, surpassing pre-crisis levels. German companies mainly supplied transportation vehicles and their parts, chemicals, and plastic materials. Goods exports to Germany remained stable at a similar level of 88 million euros in 2022. Imports from Germany increased by 42% to 610 million euros.

German companies provided transportation services in Kosovo, and Kosovo offered ICT services in Germany, with service exports growing by 43.5 million euros in 2021, while imports from Kosovo amounted to 268 million euros.

You can download the full report through this link: <https://oegjk.org/wp-content/uploads/Raporti-ekonomik-De-Ks.pdf>

## **Ligji i ri gjerman i zinxhirit të furnizimit - Çfarë duhet të kenë kujdes furnitorët kosovarë?**

Ligji i ri gjerman i zinxhirit të furnizimit, synon të përforcojë përgjegjësinë e kompanive gjermane për zinxhirët e tyre global të furnizimit.

Ligji i zinxhirit të furnizimit ka për qëllim të sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe standardeve mjedisore nga kompanitë, përgjatë zinxhirëve të tyre furnizimit.

Që nga 01.01.2023, ligji fillimisht zbatohet për ndërmarrjet me të paktën 3,000 punonjës dhe, nga viti 2024, gjithashtu për ndërmarrjet me të paktën 1,000 punonjës në Gjermani.

Në interes të planifikimit më të mirë dhe rrjedhimisht përputhshmërisë ligjore, ndryshimet në madhësinë e fuqisë punëtore nuk ndikojnë në zbatimin e LkSG.

Megjithatë, kompanitë e vogla dhe të mesme që nuk plotësojnë madhësinë minimale të lartpërmendur duhet gjithashtu t'i përmbahen kërkesave të LkSG.

LkSG u kërkon kompanive të zbatojnë një analizë rreziku në lidhje me aktivitetet e tyre të biznesit dhe marrëdhëniet e biznesit përgjatë zinxhirit të furnizimit.

Nëse kompanitë nuk përmbushin detyrimet e tyre ligjore, mund të shqiptohen gjoba administrative. Këto mund të arrijnë deri në 8 milionë euro ose deri në 2% të qarkullimit vjetor global. Sistemi i gjobave në bazë të qarkullimit vlen vetëm për kompanitë me qarkullim vjetor mbi 400 milionë euro. Për më tepër, nëse një gjobë administrative vendoset mbi një nivel të caktuar minimal, kompanitë mund të përjashtohen nga dhënia e kontratave publike.

## **The new German Supply Chain Law - What should Kosovar suppliers be aware of?**

The new German Supply Chain Law aims to strengthen the responsibility of German companies for their global supply chains.

The Supply Chain Law aims to ensure the respect for human rights and environmental standards by companies along their supply chains.

Starting from January 1, 2023, the law initially applies to companies with at least 3,000 employees, and from 2024, it also applies to companies with at least 1,000 employees in Germany.

For better planning and legal consistency, changes in workforce size do not affect the application of the Supply Chain Due Diligence Act (LkSG).

However, small and medium-sized enterprises that do not meet the aforementioned minimum size requirements must also adhere to the requirements of the LkSG.

The LkSG requires companies to conduct a risk analysis regarding their business activities and business relationships along the supply chain.

If companies fail to fulfill their legal obligations, they may face administrative fines. These fines can amount to up to 8 million euros or 2% of the company's global annual turnover. The fine system based on annual turnover applies only to companies with annual turnover above 400 million euros. Furthermore, if an administrative fine is imposed above a certain minimum level, companies may be excluded from public procurement contracts.

## **OEGJK vizitoi ekspertin gjerman Reinhold Blacha në kompaninë "Happy"**

Përfaqësueset e OEGJK-së, Elena Elshani dhe Besarta Hyseni vizituan kompaninë Happy, ku tashmë është angazhuar eksperti gjerman Reinhold Blacha, nëpërmes shërbimit ekskluziv të odës, Senior Expert Service.

Përvoja e gjatë dhe profesionalizmi i z.Blacha ka bërë që performanca e kompanisë të përmirësohet, për çka përfaqësuesit e kompanisë "Happy", u shprehën të lumtur me bashkëpunimin dhe rezultatet e përfituara.

Për të gjithë kompanitë e interesuara për të angazhuar ekspertë gjermanë me kosto minimale përmes SES, mund të drejtoheni tek përfaqësuesja e OEGJK-së për SES, Elena Elshani: [elena.elshani@oegjk.org](mailto:elena.elshani@oegjk.org).

## **KDWV visited German expert Reinhold Blacha at the company "Happy."**

Representatives from KDWV, Elena Elshani, and Besarta Hyseni visited the company "Happy," where German expert Reinhold Blacha is already engaged through the exclusive service of KDWV, Senior Expert Service.

Blacha's extensive experience and professionalism have improved the company's performance, and representatives of "Happy" expressed satisfaction with the collaboration and the results achieved.

For all companies interested in engaging German experts at minimal cost through SES, you can contact KDWV's representative for SES, Elena Elshani: [elena.elshani@oegjk.org](mailto:elena.elshani@oegjk.org).



**OEGJK merr pjesë në lansimin e raportit "Përfitimet ekonomike nga investimet në efikasitet të energjisë në Kosovë" organizuar nga Instituti GAP**

Instituti GAP ka publikuar raportin "Përfitimet ekonomike nga investimet në efikasitet të energjisë në Kosovë", në lansimin e të cilit ishte drejtuesja e Departamentit për Avokim dhe Marrdhënie Qeveritare, Sytrime Dervisholli.

Nga ky raport thuhet se Kosova ka intensitetin më të lartë të energjisë në Evropë. Sektori rezidencial është konsumatori kryesor, që do të thotë se është edhe sektori me potencialin më të lartë për kursim të energjisë.

"Përgjatë viteve 2016-2022 janë zbatuar disa projekte qeveritare, si dhe projekti i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC), ku si rezultat i investimeve të bëra është arritur kursimi prej rreth 29.61 ktoe apo rreth 344.36 GWh. Mirëpo këto projekte, veçmas ato të qeverisë, fokus të veçantë kanë pasur sektorin publik dhe në masë më të vogël sektorin rezidencial dhe Industrinë.

Nëpërmjet Strategjisë Kombëtare të Energjisë (SKE) 2022-2031 është përcaktuar objektivi ambicioz i kursimeve kumulative prej 283 ktoe deri në vitin 2031. Përderisa dokumentet strategjike dhe legjislative janë të gjitha të definuara, mungesa e zbatimit të duhur dhe mekanizmave mbështetës e ka zgjatur procesin e investimit në efikasitet të energjisë (EE).

Raporti analizon zhvillimet kryesore në sektorin e efikasitetit të energjisë, ndikimin e investimeve në efikasitet të energjisë në punësim, si dhe përfshin rekomandime rreth veprimeve që Qeveria duhet të ndërtojë për të promovuar efikasitetin e energjisë në sektorin privat", thuhet ndër të tjera.

**KDWW participates in the launch of the report "Economic Benefits from Energy Efficiency Investments in Kosovo" organized by GAP Institute.**

The GAP Institute has published the report "Economic Benefits from Energy Efficiency Investments in Kosovo," which was launched by the Director of the Department of Advocacy and Government Relations, Sytrime Dervisholli.

According to the report, Kosovo has the highest energy intensity in Europe. The residential sector is the main consumer, meaning it also has the highest potential for energy savings.

During the period from 2016 to 2022, several government projects were implemented, including the Millennium Challenge Corporation (MCC) project, resulting in savings of around 29.61 ktoe or about 344.36 GWh. However, these projects, especially those by the government, have primarily focused on the public sector and to a lesser extent on the residential and industrial sectors.

Through the National Energy Strategy (NES) 2022-2031, an ambitious cumulative savings target of 283 ktoe until 2031 has been set. While all strategic and legislative documents have been defined, the lack of proper implementation and supportive mechanisms has prolonged the process of investing in energy efficiency (EE).

The report analyzes the key developments in the energy efficiency sector, the impact of energy efficiency investments on employment, and includes recommendations on actions that the Government should take to promote energy efficiency in the private sector.



Nga të pranishmit u theksua që është nevojë emergjente rritja e kapaciteteve profesionale për zbatimin e Strategjisë së Energjisë 2022-2031.

Aty u bë e ditur se për herë të parë do të funksionalizohet Skema për Bizneset e Vogla dhe të Mesme për t'i ndërruar pajisjet. Teksa gjithashtu gjë e re do të jetë Rregullorja për Trupat Ndriçues (promovimi i ndriçimit LED).

Participants emphasized the urgent need to increase professional capacities for the implementation of the Energy Strategy 2022-2031.

During the event, it was announced that, for the first time, the Scheme for Small and Medium Enterprises for equipment replacement will be functionalized. Additionally, a new Regulation for Lighting Bodies (LED lighting promotion) will be introduced.





**Forumi Lindje-Perëndim BAYERN mbahet më 26 shtator 2023**

IHK Regensburg për Oberpfalz / Kelheim, së bashku me të gjitha dhomat bavareze të industrisë dhe tregtisë, janë duke organizuar një edicion të ri të Forumit Lindje-Perëndim BAYERN më 26 shtator 2023 në Regensburg.

Tregjet e Evropës Lindore dhe Juglindore konsiderohen partnerë të rëndësishëm tregtarë për kompanitë gjermane. Kështu që afrimi dhe diversifikimi i zinxhirëve të furnizimit është kyç.

Informacione të tjera mbi programin dhe regjistrimin gjeni në: <https://events.ihk-regensburg.de/owf-bayern2023>

Informata shitesë për forume, panaire dhe organizime të ngjashme ju mjafton të shkruani në [info@oegjk.org](mailto:info@oegjk.org), duke kërkuar asistencë.

**The East-West BAYERN Forum will be held on September 26, 2023.**

IHK Regensburg for Oberpfalz / Kelheim, along with all Bavarian chambers of industry and commerce, are organizing a new edition of the East-West BAYERN Forum on September 26, 2023, in Regensburg.

The markets of Eastern and Southeastern Europe are considered important trading partners for German companies. Therefore, the approach and diversification of supply chains are crucial.

Further information on the program and registration can be found here: <https://events.ihk-regensburg.de/owf-bayern2023>

For additional information on forums, fairs, and similar events, you can contact [info@oegjk.org](mailto:info@oegjk.org) and request assistance.

**↓ MORE INFORMATION BELOW ↓**

## YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV



Znj. Sytrime Dervisholli,  
Udhëheqëse e departamentit  
për marrëdhënie me qeverinë  
dhe avokim mund ta  
kontaktoni në:

[sytrime.dervisholli@oegjk.org](mailto:sytrime.dervisholli@oegjk.org)

Sytrime Dervisholli, Head of  
Department for Government  
Relations and Advocacy can  
be contacted at:

[sytrime.dervisholli@oegjk.org](mailto:sytrime.dervisholli@oegjk.org)

Ekipi i znj. Dervisholli nuk është vetëm përgjegjës për përfaqësimin e interesave të anëtarëve, por gjithashtu koordinon gjashtë grupet punuese të OEGJK-së, dhe punon në publikimet tona, si dhe në raportet sektoriale:

[Publikimet e OEGJK-së](#)

The team of Ms. Dervisholli is not only responsible for representing the interests of KDWV-members, but also coordinates the six working groups of KDWV, and works on our publications, as well as on sector reports:

[Publications](#)



Udhëheqëse e  
departamentit për  
mbështetjen dhe  
shërbimet e anëtarëve  
është znj. Besarta Hyseni:

[besarta.hyseni@oegjk.org](mailto:besarta.hyseni@oegjk.org)

Head of Market Entry and  
Events is:

[besarta.hyseni@oegjk.org](mailto:besarta.hyseni@oegjk.org)

Ekipi i znj. Hyseni jo vetëm që mbështet anëtarët me eksport, këshilla ligjore (kemi këshilltarë ligjorë në ekip), këshilla për Joint Venture, Franchise dhe Senior Expert Service, por gjithashtu organizon takime B2B, udhëtime delegacioni, punëtori dhe ngjarje informuese për anëtarët.

The team of Ms. Hyseni not only supports members regarding export, legal advisory services (KDWV has in-house lawyers), Joint Venture, Franchise and Senior Expert Service, but also organizes B2B meetings, delegation trips, workshops, and info-sessions for members.



Për çështje financiare (pagesa  
e anëtarësimit/faturat etj.)  
mund ta kontaktoni znj. Greta  
Kazia:

[greta.kazia@oegjk.org](mailto:greta.kazia@oegjk.org)

For financial matters  
(membership fees/invoices,  
etc.) please contact Ms. Greta  
Kazia:

[greta.kazia@oegjk.org](mailto:greta.kazia@oegjk.org)



Për këshillim ligjor të  
investitorëve gjerman dhe  
anëtarëve të OEGJK mund  
ta kontaktoni znj. Gonxhe  
Abazi:

[gonxhe.abazi@oegjk.org](mailto:gonxhe.abazi@oegjk.org)

For legal advice to German  
Investors and members of  
KDWV please contact Ms.  
Gonxhe Abazi:

[gonxhe.abazi@oegjk.org](mailto:gonxhe.abazi@oegjk.org)

### BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:

ICON Tower, 9th Floor, Rr. Bekim Fehmiu 110; 10000 Prishtina

Monday - Friday | 8.00 - 17.00